



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 427/6 akti

Tiranë, më 16.07. 2015

V E N D I M

Nr. 72, datë 16/07/2015

**“Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit
nr. 427/1 prot., datë 18.06.2015”**

Bazuar në urdhrin e verifikimit nr. 427/1 prot. datë 18.06.2015, lidhur me rastin e paraqitur nga ***** ish-Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Institutit të Statistikave, në lidhje me moskonfirmimin nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014 neni 24 dhe 62 i ligjit, dhe mbështetur në nenin 13, 14 germa “a” dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17 datë 11.03.2015,

VËREJ:

Nga verifikimi i bërë në dokumentacionin që ndodhet pranë Institutit të Statistikave dhe nga komunikimi me personin e kontaktit ***** , Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, pas administrimit të provave dhe akteve shkresore, rezultoi:

Punonjësjë ***** ka marrë pjesë në konkursin e shpallur nga Instituti i Statistikave, për pozicionin vakant “Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse”, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, që ishte efektiv në atë kohë. Në përfundim të procedurës së konkurimit, ***** shpallet fitues me aktin nr. 782/2 prot., datë 02.08.2013, nga komiteti ad-hoc i ngritur për këtë konkurim me aktin nr. 782/1 prot., datë 29.07.2013. Pas kësaj, me aktin nr. 782/3 prot., datë 20.10.2013, emërohet në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe

Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse”, kategoria III-a1, në periudhë prove për një vit, në Institutin e Statistikave.

Në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar (i cili i filloi efektet në datën 26.02.2014), Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 1208/123 prot., datë 30.10.2014, deklaroi statusin e punësimit të ***** nëpunëse civile në periudhë provë në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse*”.

Periudha e provës e ***** rregullohej fillimisht me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, i cili u shfuqizua me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”. Nga verifikimi i bërë mbi trajtimin procedural dhe ligjor të periudhës së provës rezultoi se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka zbatuar drejt kërkesat e përcaktuara në pikën 4, të kreut IV “*Dispozita tranzitore*”, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në të cilën citohet se: “Nëpunësit civilë, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe që janë në periudhë prove, vazhdojnë periudhën e provës sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj*”.

Kjo drejtori, si fillim të periudhës së provës për nëpunësen në fjalë ka marrë datën e emërimit të saj (datën 20.10.2013) dhe në përfundim të periudhës një vjeçare të provës, me aktin nr. 782/4 prot., datë 20.10.2014, të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka vendosur zgjatjen me gjashtë muaj të periudhës së provës. Ndërkohë, kjo punonjëse i është nënshtruar programit të detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) duke e përfunduar atë me sukses.

Bazuar në nenin 62, pika 1, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” dhe VKM nr. 109, datë 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, sipas formularit të vlerësimit të punës për nëpunësit civilë, të administruar gjatë hetimit administrativ, nëpunësja ***** për rezultatet e arritura në punë në përfundim të periudhës së provës (një vit plus gjashtë muaj) është vlerësuar “*jo kënaqshëm*” nga zyrtari raportues, nënshkruar edhe nga zyrtari kundërfirmues dhe autorizues (që në këtë rast është i njëjti person). Në këtë formular rezultoi se kanë qenë objekt i vlerësimit si realizimi i objektivave, ashtu edhe sjellja profesionale. Është treguar kujdes që të plotësohen të gjitha ndarjet e formularit, si të dhënat personale, konteksti i punës, objektivat dhe matësit e performancës, sjellja profesionale, etj. Si rrjedhojë, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Institutit të Statistikave, në cilësinë e eprorit direkt, me shkresën nr. 782/5 prot., datë 25.05.2015, me lëndë “*Vendim për, moskonfirmimin nëpunës civil*”, ka vendosur të moskonfirmojë punonjësen ***** si nëpunës civil. Me rënien në dijeni të vlerësimit “*jo kënaqshëm*”, në datën 18.05.2015, në ndarjen D), “*Nënshkrimi*”, nëpunësja në fjalë ka deklaruar se ka marrë dhe ka lexuar vlerësimin dhe nuk është dakord. Ashtu siç parashikohet në në kreun V, të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, zyrtari autorizues (që është titullari i institucionit) ka shqyrtuar ankimin dhe ka bërë rivlerësimin në datën 22.05.2015, duke mbajtur të njëjtin qëndrim (të arsyetuar me shkresën nr. 782/7 prot., datë 11.06.2015). Rivlerësimi është

shënuar dhe nënshkruar nga titullari i institucionit (*zyrtari kundërfirmues dhe autorizues njëkohësisht*) në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se procedura ligjore e ndjekur deri në nxjerrjen e aktit administrativ nr. 782/5 prot., datë 25.05.2015, "*Vendim për moskonfirmim nëpunës civil*", është në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i cili parashikon rastin e moskonfirmimit të nëpunësit në pikën 3/c dhe 4, ku përmendet e drejta e institucionit që të mos konfirmojë nëpunësin në fund të periudhës së provës, në rastin e një vlerësimi negativ.

Sa më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave, me aktin nr. 782/8 prot., datë 12.06.2015, "*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*", ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për nëpunësen *****.

Sa më sipër, konkludojmë se:

1. Moskonfirmimi si nëpunës civil i ***** është në përputhje me ligjin për shërbimin civil dhe aktet nënligjore datë në bazë e për zbatim të tij. Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës është sipas përcaktimeve të Vendimit nr.109 datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave "*Për Vlerësimin e Rezultateve në punë të nëpunësve civilë*". Akti nr. 782/5 prot., datë 25.05.2015, "*Vendim për moskonfirmim nëpunës civil*", ka dalë si rezultat i vlerësimit të përgjithshëm të rezultateve të punës "*jo kënaqshëm*". Ky vendim është në përputhje me pikën 4, të nenit 24, të ligjit 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: "*Vendimi, sipas pikës 3 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale në punë dhe në rezultatit e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s*",

dhe të pikës 7/a, të kreut V "*Periudha e provës*", të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave "*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*" (që ishte efektiv në atë kohë) në të cilin përcaktohet se: "*konfirmohet nëpunës civil, nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe është vlerësuar të paktën "kënaqshëm"*.

Për këto arsye,

në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 dhe nenit 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ, iniciuar në bazë të Urdhërit nr. 427/1 prot. datë 18.06.2015, *“Për verifikimin e rastit të paraqitur nga ***** në lidhje me moskonfirmimin nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës”*.
2. Të njoftohen për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Instituti i Statistikave dhe shtetasi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA